



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.143/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Laziq dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Besianë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në shtylla elektrike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërkaq subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Besianë i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 08.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 08.10.2017, në në fshatin Sibovc, në Besianë, monitoruesit e tyre kanë hasur në njoftim për tubim nga subjekti politik LDK, të vendosur mbi rrugë publike përkatësisht në shtyllë elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin që ka vendosur njoftimin për tubim në rrugë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur 2 fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK, të datës 09.10.2017, nuk kanë pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se të njëjtit posedojnë leje për shfrytëzimin e hapësirës publike për bërje fushatë nga subjekti i tyre politik.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një shkresë të lëshuar më datë 22.09.2017 nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se billbordi i kandidatit për kryetar të Komunës së Mitrovicës, nga radhët e subjektit politik AKR janë vendosur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar shkeljen e supozuar, pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Ndërsa, veprime që kanë ndërmarrë për të bërë përmirësimin e shkeljes nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitjes**

ZL.Anr.143 /2017 më datën 10.10.2017

Prishtinë / Pristina

**Kryesuesi i Panelit**

Zyhdi Haxhiri

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.